

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Have Haliti, kryetare, Fillim Skoro e Abdullah Ahmeti, anëtar, me bashkëpunëtori profesional Përparim Zeka, si procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarve: V.I., për shkak të dy veprave penale kryerja e veprës terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 dhe 31 të KPRK dhe veprës penale importimi, ekspertimi, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve materieve plasëse, nga neni 372 par.1 të KPRK, B.I., për shkak të veprës penale kryerja e veprës terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 dhe 35 të KPRK, L.V., për shkak të veprës penale kryerja e veprës terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 dhe 31 të KPRK, K.P. për shkak të veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par.1 të KPRK, A.A., për shkak të veprës penale përgatitja e veprave terroriste ose veprës kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 179 nën par.1.9 lidhur me nenin 31 të KPRK, L.G. për shkak të veprës penale përgatitja e veprave terroriste ose veprës kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 179 nën par.1.9 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPRK, L.M., për shkak të veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe fshehja ose mos lajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste nga neni 142 par.2 lidhur me nenin 385 par.2 nën par.2.4 të KPRK dhe B.P., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, mbrojtësit të akuzuarit V.I., av.A.L., të ankesës së të akuzuarit B.I. dhe ankesës së përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit B.I., av.H.J. dhe av.N.D., të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit L.V., av.S.M., ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit F.G., av.M.B., ankesës së mbrojtësit të akuzuarit K.P. av.A.I., ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit A.A., av.Z.Gj., ankesës së mbrojtësit të akuzuarit L.G. av.B.S., ankesës së mbrojtësit të akuzuarit L.M., av.G.B., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.203/2017, të dt.18.05.2018, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me dt.17.09.2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të akuzuarve V.I., L.V., F.G., A.A., L.G. L.M., B.P., si dhe ankesës së përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit B.I., dhe të ankesës të akuzuarit B.I., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.203/2017, të ddt.18.05.2018, përkitazi me cilësimin juridik dhe vendimin mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit, për të akuzuarit A.A. dhe L.G. për veprën penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 179 nën par.1.9 lidhur me nenin 31 të KPRK, e më afër të përshkruar si në dispozitivin II të aktgjykimit, e cilëson në veprën penale përgatitja e veprave

terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK, dhe të Akuzuarit V.I., për veprën penale kryerja e veprës terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, më afër të përshkruar si në dispozitivun I të aktgjykimit, dënim e shqiptuar në kohëzgjatje prej 9(nëntë)vite merret si i vërtetuar , për veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transporti, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve apo materive plasëse nga neni 372 par.1 dhe par.4 të KPRK, më afër të përshkruar si në dispozitivun III të aktgjykimit , dënimi i shqiptuar me gjobë në shumë prej 1.800 euro dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve merret si i vërtetuar, dhe për dy vepra penale ia shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 8(tetë)vite, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.04.11.2016 e tutje, si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 1800Euro, e të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse dënimin e shqiptuar me gjobë nëse nuk e paguan ë afatin e caktuar njëjti do të nxirret me detyrim, ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet një ditë burgim. Të akuzuarit B.I., për veprën penale fshehja ose mos lajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste nga neni 142 par.2 lidhur me nenin 135 par.2 nën par.1.4 të KPRK, më afër të përshkruar si në dispozitivun I të aktgjykimit ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)vite e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.04.11.2016 deri me dt.16.12.2016. Të akuzuarit L.V., për veprën penale kryerja e veprës terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, më afër të përshkruar si në dispozitivun I të aktgjykimit ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër)viteve, e në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.04.11.2016, e tutje. Të akuzuarit F.G., për veprën penale kryerja e veprës terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, më afër të përshkruar si në dispozitivun I të aktgjykimit, ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër)viteve, e në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.09.11.2016, e tutje. Të akuzuarit L.G. për veprën penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK më afër të përshkruar si në dispozitivun II të aktgjykimit, dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve e merr si të vërtetuar, për veprën penale organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par 2 të KPRK, më afër të përshkruar si në dispozitivun VI të aktgjykimit, dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë)viteve e merr si të vërtetuar, dhe për dy vepra penale ia shqipton dënimin unik në kohëzgjatje prej 5(pesë)vite 3(tre)muaj, e në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.06.11.2016 e tutje. Të akuzuarit L.M., për veprën penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 të KPR, më afër të përshkruar si në dispozitivun V të aktgjykimit dënimin me dënim në kohëzgjatje prej 1(një)viti e merr si të vërtetuar për veprën penale fshehja ose mos lajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste nga neni 142 par.2 lidhur me nenin 385 par.2 nën par.1.4 të KPRK, më afër të përshkruar si në dispozitivun IV të aktgjykimit dënimin e shqiptuar në kohëzgjatje prej 3(tri)vite, e merr si të vërtetuar dhe për dy vepra penale ia shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)vite ,në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.04.11.2016, deri me dt.13.04.2017.

II. Ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës , dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit K.P. av,A.I., refuzohen si të pabazuara.

III. Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa prekur.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR Prishtinë, PKR.nr.203/2017, të dt.18.05.2018, të akuzuarit janë shpallur fajtor edhe atë: të akuzuarit V.I., B.I., L.V. dhe F.G., për veprën penale në bashkëkryerje kryerja e veprës terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 dhe 31 të KPRK, ndërsa i akuzuari B.I., për veprën penale fshehja ose mos lajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste nga neni 142 par.2 lidhur me nenin 385 par.2 nën par.2.4 të KPRK, të akuzuarit A.A. dhe L.G. për veprën penale në bashkëkryerje përgatitja e veprave terroriste ose veprës kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 179 nën par.1.9 lidhur me nenin 31 të KPRK, të akuzuarit V.I. dhe K.P. secili veç e veç për veprën penale importimi, ekspertimi, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve materieve plasëse, nga neni 372 par.1 të KPRK, i akuzuari L.G. për veprën penale organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPRK, të akuzuarit L.M. dhe B.P., secili veç e veç për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe L.M., për veprën penale fshehja ose mos lajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste nga neni 142 par.2 lidhur me nenin 385 par.2 të nën par.2.4 të KPRK, të cilët janë gjykuar:

Të akuzuari V.I., për veprën penale nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 dhe nenin 31 të KPRK, i caktohet dënimi individual dënim me burg në kohëzgjatje prej 9(nëntë)viteve, për veprën penale nga neni 372 par.1 dhe par.4 të KPRK, i caktohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1.800(njëmijetëqind)Euro, si dhe dënimin me burg në kohëzgjatje prej 2(dy)vite, i shqipton dënim unik me gjobë në lartësi prej 1.800(njëmijetëqind)Euro, të cilën shumën duhet të paguaj brenda afatit prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit si dhe dënimin me burg në kohëzgjatje prej 10(dhjetë)vite, të cilin do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dënimin me burg i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.04.11.2016, e tutje.

Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë sipas këtij aktgjykimit, atëherë ky dënim me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20Euro të dënimin me gjobë do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Nga tani i akuzuari V.I., të kompensohet eksplozivi i improvizuar "TAPT", në sasi prej 283.1gr. si send me të cilin është kryer vepra penale nga neni 372 par.1 të KPRK.

Të akuzuarin B.I., për veprën penale nga neni 142 par.2 lidhur me nenin 385 par.2 nën par.2.4 të KPRK, i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 3(tri)vite, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dënimin e shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.04.11.2016, e deri me dt.16.12.2016.

Të akuzuarit L.V., për veprën penale nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 dhe nenin 31 të KPRK, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë)vite, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dënimin me burg i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.04.11.2016 deri me dt.25.10.2017, si dhe koha e kaluar në paraburgim pas shpalljes së aktgjykimit nga dita e ndalimit dhe dërgimit në Qendrën e Paraburgimit e deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit.

Të akuzuarit F.G., për veprën penale nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 dhe nenin 31 të KPRK, i ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 5(pesë)vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej dt.09.11.2016, e tutje.

Të akuzuarit K.P. për veprën penale nga neni 372 par.1 të KPRK, i shqipton dënim me gjobë në lartësi prej 1.800(njëmijetëqind)Euro, si dhe dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1(një)viti e 6(gjashtë)muaj, të cilin do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Në dënimin me burg i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.09.11.2016 e deri me dt.21.12.2017.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë sipas këtij aktgjykimit, atëherë ky dënim me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20Euro, të dënimit me gjobë do ti caktohet një ditë burg.

Të akuzuarit A.A., për veprën penale nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 179 par.1.9 dhe nenin 31 të KPRK, i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 1(një)viti e 6(gjashtë)muaj, të cilin do të mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dënimin me burg i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.06.11.2016 e deri me dt.21.12.2017.

Të akuzuarin L.G. për veprën penale nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 179 par.1.9 dhe nenin 31 të KPRK, i ka caktuar dënimin individual dënim me burg në kohëzgjatje prej 2(dy)vite dhe për veprën penale nga neni 143 par.2 të KPRK; i cakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 5(pesë)vite, më pastaj i shqipton dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)vite, në të cilën i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.06.11.2016 e tutje.

Të akuzuarit L.M., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK, i cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, ndërsa për veprën penale fshehja ose mos lajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste nga neni 142 par.2 lidhur me nenin 385 par.2 nën par.2.4 të KPRK, i cakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3(tri)vite, dhe për këto vepra penale ia shqipton dënimin unik në kohëzgjatje prej 3(tri)vite e 6(gjashtë)muaj, në të cilën i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.04.11.2016 deri me dt.13.04.2017.

Të akuzuarit L.M., i konfiskohen tre fishek të gjuetisë të kal.12mm, një jelek taktik i ushtrisë, dy karikator të zbrazët, një karikator me njëzet fishek të kal.7.62mm, katër karikator secili me nga 30 fishek të kal.7.62mm, si sende me të cilat është kryer vepra penale nga neni 374 par.1 të KPRK.

Të akuzuarit B.P., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 2.500(dymijepesëqind)Euro, të cilin do ta paguaj brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në dënimin me gjobë i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.08.11.2016 e deri me dt.16.12.2016, ashtu që për çdo ditë të mbajtur në paraburgim i llogariten nga 20Euro të dënimit me gjobë.

Të akuzuarit janë obliguar V.I., B.I., L.V., F.G., K.P. A.A., L.G. L.M. dhe B.P., secili veç e veç janë obliguar që të kompensojnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare në pjesë të barabarta, si dhe secili veç e veç është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumë prej nga 250(dyqindpesëdhjetë)Euro, si dhe secili veç e veç në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumë prej nga 50(pesëdhjetë)Euro, e të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesë:

-Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari B.I. të shpallet fajtor për veprën penale kryerja e veprës terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 dhe nenin 31 të KPRK, ndërsa të akuzuarve të tjerë t'iu ashpëron dënimet.

-Mbrojtësi i të akuzuarit V.I., av.A.L., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të ligjit shkeljes së dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit V.I., ti ndërprehet paraburgim dhe të mbrohet në liri, ndërsa çështja penale të kthehet në rigjykim dhe vendim.

-Mbrojtësit e të akuzuarit B.I. av.N.D. dhe av.H.J., dhe i akuzuari B.I., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ta anuloj aktgjykimin dhe çështjen penale ta kthejë në rigjykim dhe vendim apo që aktgjykimin ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza.

-Mbrojtësi i të akuzuarit L.V., av.S.M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin dhe të akuzuarin L.V., në mungesë të provave ta liroj nga akuza ose çështja penale të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe vendim.

-Mbrojtësja e të akuzuarit F.G., av.M.B., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza.

-Mbrojtësi i të akuzuarit K.P. av.A.I., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të butë, me zvogëlimin e lartësisë së dënimit.

-Mbrojtësja e të akuzuarit A.A., av.Z.Gj., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin dhe të akuzuarit A.A., ti shqiptoj një dënim më të butë apo të kushtëzuar ose çështja penale të kthehet në rigjykim dhe vendim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit L.G. av.B.S., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, vendimit mbi dënimin dhe shpenzimeve të paushallit gjyqësor, me propozim që Gjykata e Apelit, ta

ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza për veprat penale për të cilat është akuzuar ose çështjen penale ta anulon dhe të njëjtën ta kthejë në rigjykim dhe vendim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit L.M., av.G.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen penale ta kthejë në rigjykim dhe vendim ose që aktgjykimin ta ndryshoj dhe të akuzuarit ti shqiptoj një dënim të kushtëzuar.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.1343/2018, të dt.03.08.2018, duke u sqaruar përkitazi në ankesat e PRSK dhe të mbrojtësve të akuzuarve, ka propozuar që ankesa e PRSK të aprovohet si e bazuar ndërsa të refuzohen si të pabazuara ankesat e të akuzuarve V.I., av.A.L., L.M., av.G.B., L.V., av.S.M., e të akuzuarit K.P. av.A.I., F.G., av.M.B., A.A., av.Z.Gj., L.G. av.B.S. dhe ankesa e përbashkët e B.I. av.N.D. dhe av.H.J.,

Gjykata e Apelit në pajtim me nenin 390 par.1 të KPP, caktoi seancën e kolegjit ku morën pjesë i akuzuari V.I. dhe mbrojtësi i tij, av.A.L., i akuzuari B.I. dhe mbrojtësi i tij, av.H.J., i akuzuari L.V. dhe mbrojtësi i tij, av.S.M., i akuzuari F.G. dhe mbrojtësja e tij av.M.B., av. Nazmije Ibrahimimi me autorizim zëvendësues nga av.A.I., për të akuzuarin K.P. av.Z.Gj. për të akuzuarin A.A., i akuzuari L.G. dhe mbrojtësi i tij, av.B.S., av.G.B. për të akuzuarin L.M. dhe i akuzuari B.P., kurse munguan Prokurori i Apelit, i akuzuari K.P. i akuzuari A.A. dhe L.M., dhe av.N.D., të ftuar në mënyrë të rregullt, mungesën nuk e kanë arsyetuar dhe seanca është mbajtur në mungesë të tyre, në pajtim me dispozitën e nenit 390 par.4 të KPP, ngase pjesëmarrja e tyre nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore dhe sipas detyrës zyrtare e në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPK, vlerësoi pretendimet ankimore të PRSK, dhe të mbrojtësve të akuzuarve V.I., B.I., L.V., F.G., K.P. A.A., L.G. dhe L.M. e edhe sipas detyrës zyrtare, pas vlerësimit të shkresave të lëndës e duke marrë parasysh edhe mendimin e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, ka gjetur se:

Ankesat e mbrojtësve të akuzuarve V.I., B.I., L.V., F.G., A.A., L.G. dhe L.M., janë të bazuara, ndërsa ankesa e PRSK, dhe e mbrojtësit të akuzuarit K.P. refuzohen si të pabazuara.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, në ankesën e saj, pretendon se për të akuzuarin B.I., është shkelur ligji penal për arsye se V.I., B.I., L.V. dhe F.G., kanë kryer veprën penale, kryerja e veprës terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, e të akuzuarin A.A. dhe L.A., për veprën penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rrëndit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 nën par.1.1 e në lidhje me nenin 179 nën par.1.9 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, ndërsa i akuzuari B.I., është shpallur fajtor për veprën penale fshehja ose mos lajmërimi i grupeve terroriste nga neni 142 par.2 lidhur me nenin 385 par.2 nën par.2.4 të KPRK, për të cilën vepër penale nuk janë përmbledhur tiparet e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe i akuzuari B.I., aktivist ka marrë pjesë në përgatitjen e veprës penale bashkë me të akuzuarit tjerë. Edhe vendimi mbi dënimin nuk është adekuat me shkallën e përgjegjësisë shoqërore të veprave penale dhe shkallën e radikalizmit të akuzuarve me ideologjinë militante të ISIS-it dhe me këto dënime nuk përmbushet qëllimi i paraparë si në nenin 34 të KPRK dhe me dënimet e shqiptuara

nuk do të arrihet rehabilitimi i të dënuarve dhe nuk do të parandaloj kryesit që në të ardhmen mos të kryejnë vepra të tilla.

Mbrojtësit e të akuzuarve V.I., B.I., L.V., F.G., K.P. A.A., L.G. dhe L.M. dhe të ankesës vetë të akuzuarit B.M., e në të cilat ankesa janë paraqitur pretendimet ankimore për bazat e njëjta ankimore e të cilat janë të njëjta apo të ngjashme, në ankesat e tyre kanë cekur se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 dhe par.2 pika 2.1 dhe 2.2 të KPP, e në lidhje me nenin 370 par.7 dhe 8 të KPP, se gjykata nuk ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare dhe nuk ka nxjerrë përfundime të drejta dhe të qarta lidhur me veprimet inkriminuese të akuzuarve, duke mos dhënë arsye se cilat prova i konsideron të provuara në kryerjen e veprave penale dhe përgatitjen që të akuzuarit të kryejnë sulme terroriste, se të akuzuarit nuk kanë qenë në dijeni në kryerjen e veprave penale për të cilat janë shpallur fajtor dhe gjykata nuk ka vërtetuar dashjen e tyre, për secilin të akuzuar, për pjesëmarrjen e tyre në kryerjen e veprave penale për të cilat kanë qenë të akuzuar dhe janë shpallur fajtor. Se është përjashtuar publiku në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 384 par.1 nën par.1.4 të KPRK, se aktgjykimi është mbështetur në prova të pa pranueshme, se gjykata ka tejkaluar akuzën dhe çështja penale nuk është gjykuar plotësisht.

Sipas ankesave dhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse aktgjykimi mbështetet në prova të supozuara dhe në dëshmi të dëshmitarëve-zyrtarëve policor, të cilët kanë kryer hetimet, vëzhgimet dhe përgjimet telefonike, në të cilat edhe mbështetet aktgjykimi, e pa u vërtetuar veprimet konkrete të akuzuarve dhe pjesëmarrja e tyre në kryerjen e veprave penale për të cilën kanë qenë të akuzuar, për të cilën janë shpallur fajtor dhe nuk është aplikuar dispozita e nenit 3 të KPP, se kur ekzistojnë mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve vendimtare, ato gjithmonë interpretohen në favor të akuzuarve.

Në ankesa pretendohet se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarve, për arse se në veprimet e tyre nuk formohen elementet e veprave penale, për të cilat ata janë shpallur fajtor, e sidomos gjykata nuk ka dhënë asnjë fakt vendimtar lidhur me ekzistimin e dashje të akuzuarve për kryerjen e veprave penale, por aktgjykimi mbështetet në prova të pa pranueshme të zyrtarëve policor të cilët kanë dëshmuar në këtë çështje penale dhe është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarve, si pasojë e këtyre shkeljeve edhe vendimet mbi dënimin për secilin të akuzuar janë të pa bazuara për arsye se në veprimet e të akuzuarve nuk vërtetohen elementet e veprave penale për të cilat janë shpallur fajtor dhe kryesisht në ankesa është kërkuar lirimi i të akuzuarve nga akuza ose për shkak të mos vlerësimit të rrethanave rënduese ose lehtësuese që të akuzuarve t'iu zbuten dënimet.

Gjykata e Apelit, vlerësoi pretendimet ankimore të PRSK dhe të mbrojtësve të akuzuarve V.I., B.I., L.V., F.G., K.P. A.A., L.G. dhe L.M., në pajtim me dispozitat e nenit 394 par.1 të KPP, edhe sipas detyrës zyrtare dhe gjen se aktgjykimi nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dispozitivet e aktgjykimit të ankimuar nën I, II (përveç cilësimit ligjor të veprës penale), III, IV, V dhe VI, janë të qarta, të kuptueshme dhe nuk ekzistojnë kundërshtime në mes dispozitiveve të paraqitura në aktgjykim dhe nuk ekzistojnë kundërshtime me arsyet e paraqitura në aktgjykim. Në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të qarta dhe të plota, mbi të gjitha faktet relevante dhe aktgjykimi përmban të gjitha faktet dhe rrethanat për veprat penale për të cilat të akuzuarit V.I., B.I., L.V., F.G., K.P. A.A., L.G. dhe L.M., janë shpallur fajtor. Aktgjykimi është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.1 të KPP, dhe nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve se aktgjykimi mbështetet në prova të pa pranueshme, si pretendohet në ankesë, dhe çështja penale është gjykuar tërësisht, si është paraqitur në objektin e akuzës.

Gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me dashjen e të akuzuarve dhe në këtë drejtim ankesat e mbrojtësve të akuzuarve janë të pabazuara për arsye se gjykata nxjerr përfundime të drejta dhe të qarta lidhur me dashjen e të akuzave për arsye se këtu kemi të bëjmë me veprime përgatitore e jo me kryerjen e veprës penale, dhe nga provat e mbledhura CD, fotove, incizimet në vendin e ngjarjes, afër stadiumit "Loro Boriqi", qëllimi i të akuzuarve akuzuarve V.I., L.V. dhe F.G., ka qenë vendosja e eksplozivit nën urën e cila gjendet në hyrje të qytetit të Shkodrës kur të kalon autobusi me futbollistët e Izraelit eksplozivi i vendosur të aktivizohet prej distanece, e këto fakte vendimtare mbështeten nga dëshmitë e dëshmitarëve të dhnë dhe në shqyrtimin gjyqësor nga dëshmitë e dëshmitarëve N.H., J.J. e M.R., të cilët vërtetojnë se nga skica e vendit të ngjarjes Power Point, se të akuzuarit V.I. dhe L.V., kanë vëzhguar objektin e stadiumit "Loro Boriqi", në Shkodër, për së afërmi ku është planifikuar kryerja e veprës penale, kanë pasur edhe eksploziv që është gjetur në banesën e të akuzuarit V.I., për të cilën është dhënë edhe ekspertiza nga FBI-ja. Edhe dëshmitari M.R., deklaron lidhur me ekspertizën dhe vazhdon se ekspertiza është dërguar në SHBA në FBI dhe është konstatuar se eksplozivi është i llojit të "TATP", dhe ky eksploziv mund të përdoret nga personat që kanë për qëllime kryerjen e veprave terroriste apo kriminale. Këto fakte vërtetohen dhe raporti i vëzhgimit nga fotografitë dhe CD, me rasti e masave të fshehta se të akuzuarit V.I. dhe L.V. dhe të akuzuarit B.I., F.G., K.P. A.A., L.G. L.M. dhe B.P., kanë kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor, përfshirë edhe veprat e ri cilësuar për të akuzuarit A.A. dhe L.G..

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare, e këto mbështeten, nga provat materiale nga bastisjet të cilat janë bërë në shtëpitë e të akuzuarve ku janë gjetur eksplozivi në shtëpinë e të akuzuarit V.I. dhe K.P. si dhe armët të cilat janë gjetur te të akuzuarit L.M. dhe B.P., tre fishek gjuetie të kal.12mm, jelek taktik i ushtrisë, dy karikator, një karikator me 20 fishek të kal.7.62mm, katër karikator me nga 30 fishek, një pushkë gjysmë automatike, 80 copë fishek, të kal.7.62mm, një çantë e pushkës dhe gjashtë krerë për fishek, nga eksperti i Policisë së Kosovës për çështje të eksploziveve, e cila është gjetur te i akuzuari V.I., e të cilat janë dërguar në FBI, dhe pas ekzaminimit të kryer ka rezultuar se është eksploziv "TATP", e cila substancë eksplozive ka shpejtësi prej 5300m/s, e cila është e ndjeshme dhe ky eksploziv i cili prodhohet në mënyrë artizanale e në peshë prej 283,1gr. po qese do të eksplodonte në fushë të hapur zona eksploduese fatale kishte me qenë 2-6m, me lëndime të rënda deri në 92m, e cila konsiderohet si zonë e rrezikshme për shkaktimin e lëndimeve dhe dëmeve materiale. Nga provat e nxjerra i akuzuari V.I., i cili ka qenë në lidhje edhe me të akuzuarit e tjerë, ka pasur kontakte direkte me L.M. e e nga kjo rezulton dhe gjykata nxjerr përfundim të drejt, edhe pse kemi të bëjmë me veprime përgatitore vepra penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, konsiderohet e kryer, pavarësisht se kanë munguar pasojat e dëmshme, e të gjitha këto tregojnë qëllimin dhe dashjen e të akuzuarve të cekur më lartë për kryerjen e veprave penale, për të cilat janë shpallur fajtor dhe të gjitha këto prova tregojnë se të akuzuarit kanë planifikuar kryerjen e veprave penale terroriste për të cilat vepra dhe janë shpallur fajtor, e këtë duke marrë parasysh se të akuzuarit A.A., K.P. dhe B.P., kanë pranuar fajësinë, për veprën penale përgatitja e veprave penale ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së R. Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, i akuzuari K.P. ka pranuar veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par.1 të KPRK, ndërsa i akuzuari B.P., ka pranuar fajësinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe si rezulton nga shkresat e lëndës ky pranim i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat të cilat janë paraqitur në akuzë e të cilat janë edhe prova materiale e me të cilat mbështetet pranimi i fajësisë i paraparë si në nenin 248 par.1 nën par.1.1 gjerë në 1.4 të KPP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet ankimore se është përjashtuar publiku në kundërshtim me nenin 384 par.1 nën par.1.4 të KPP, janë të pabazuara, kjo për arsye se sipas dispozitës së nenit 294 par.1 të KPP, në rastet e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor sipas detyrës zyrtare përjashtohet publiku për ruajtjen e fshehtësive zyrtare dhe ruajtjet e informacioneve të fshehta për arsye se kemi të bëjmë me vepra penale të cilat hyjnë në grupin e veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, gjë që gjykata ka marr vendim të drejtë kur është përjashtuar publiku me rastin e dëgjimit të dëshmitarëve N.H., J.J., e M.R., si ekspert i policisë për çështje të eksploziveve dhe mbajtja e shqyrtimit gjyqësor për vepra penale të tilla, do të ishte në kundërshtim me interesat kombëtare dhe nacionale të Republikës së Kosovës.

Gjykatës e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të cekura në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë janë të pabazuara, për arsye se në shqyrtimin gjyqësor nga shkresat e lëndës dhe provat materiale në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit V.I., B.I., L.V. dhe F.G., kanë planifikuar kryerjen e veprës terroriste nga neni 136 bashkë me të akuzuarit A. dhe L.G. të cilët kanë planifikuar në bashkëkryerje përgatitjen e veprave penale terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 të KPRK, dhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë nga gjykata se të akuzuarit e cekur më lartë kanë pasur qëllim dhe dashje dhe përmes L.M., janë përgjigjur thirrjes të organizatës terroriste ISIS, me anë të internetit-aplikacionit telegram, ku është bërë thirrje të kryhet sulmi terrorist kundër lojtarëve dhe tifozëve nga Izraeli, për të luajtur ndeshjen futbolistike në qytetin e Shkodrës dhe L.M. të akuzuarit V.I. dhe të akuzuarve L.V. dhe F.G., u ka dërguar eksploziv të improvizuar të TAPT rreth 2kg, dhe të holla prej 1.350Euro, për të kryer sulmin dhe të akuzuarit kanë hyrë në Shqipëri dhe kanë vëzhguar stadiumin “Loro Boriqi”, më bërjen e fotografive dhe meqë siguria ka qenë e lartë, janë tërhequr nga veprimet e tyre dhe kanë vendosur që eksplozivin ta vendosin nën urën e cila gjendet në hyrje të qytetit të Shkodrës, i cili do të aktivizohej nga distanca, ndërsa të akuzuarit A.A. dhe L.G. janë interesuar për blerjen e armëve automatike, ndërsa L.M., këtyre do tu dërgonte shumë prej 1.500Euro, e i akuzuari L.G. me dt.01.11.2013, nga aeroporti i Prishtinës, ka shkuar në Stamboll, e me qëllim ti bashkëngjitet grupit të shqiptarëve të cilët kanë qenë pjesë e grupit militantë ekstremistë “All Nusra”, i akuzuari L.M., ka pasur gjithmonë biseda të vazhdueshme me të akuzuarit V.I., B.I., L.V. dhe F.G., përmes internetit dhe ka qenë në dijeni për ekzistimin e grupit terrorist, e cila ka qenë në përbërje të akuzuarve V.I., L.V. dhe F.G., po ashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari V.I., është furnizuar me 283,1gr.eksploziv të improvizuar të TAPT, e cila është gjetur në podrumin e shtëpisë së tij, ndërsa te i akuzuari K.P. është gjetur një kavanoz qelqi, materie plasëse ANFO, Gjykata në tërësi ka vërtetuar gjendjen faktike për të akuzuarit L.M. dhe B.P., se te i akuzuari L.M., janë gjetur tre fishek gjuetie me kal.12mm, një jelek taktik i ushtrisë, 20 fishek të kal.7.62mm, 30 fishek të kal.7.62mm dhe karikator, ndërsa te i akuzuari B.P., në shtëpinë e tij është gjetur në pushkë gjysmë automatike me 80 copë fishek të kal.7.62mm, një çantë e pushkës dhe 6 krerë për fishek dhe kjo gjendje faktike është vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe provave materiale të cilat janë cekur më lartë dhe kjo gjendje faktike e vërtetuar nga gjykata është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Gjykatës e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve, se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarve, janë të pabazuara, edhe pse kemi të bëjmë më veprime përgatitore dhe mungojnë pasojat e dëmshme, veprat penale kryerja e veprës terroriste nga neni 136 lidhur me nenin 145 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, vepra penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rrëndit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 të KPRK, si dhe vepra penale organizimi dhe

pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPRK, kanë marrë pjesë të akuzuarit V.I., B.I., L.V., F.G., A.A., L.G. dhe L.M., konsiderohen si vepra penale të kryera edhe përkundër mos ekzistimit të pasojave të dëmshme, se në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit kanë pasur qëllim dhe dashje dhe përmes L.M., janë përgjigjur thirrjes të organizatës terroriste ISIS, me anë të internetit-aplikacionit telegram, ku është bërë thirrje të kryhet sulmi terrorist kundër lojtarëve dhe tifozëve nga Izraeli, për të luajtur ndeshjen futbolistike në qytetin e Shkodrës dhe L.M. të akuzuarit V.I. dhe të akuzuarve L.V. dhe F.G., u ka dërguar eksploziv të improvizuar të TAPT rreth 2kg, dhe të holla prej 1.350Euro, për të kryer sulmin dhe të akuzuarit kanë hyrë në Shqipëri dhe kanë vëzhguar stadiumin "Loro Boriqi", më bërjen e fotografive dhe meqë siguria ka qenë e lartë, janë tërhequr nga veprimet e tyre dhe kanë vendosur që eksplozivin ta vendosin nën urën e cila gjendet në hyrje të qytetit të Shkodrës, i cili do të aktivizohej nga distanca, ndërsa të akuzuarit A.A. dhe L.G. janë interesuar për blerjen e armëve automatike, ndërsa L.M., këtyre do tu dërgonte shumën prej 1.500Euro, e i akuzuari L.G. me dt.01.11.2013, nga aeroporti i Prishtinës, ka shkuar në Stamboll, e me qëllim ti bashkëngjitet grupit të shqiptarëve të cilët kanë qenë pjesë e grupit militantë ekstremistë "Al Nustra", i akuzuari L.M., ka pasur gjithmonë biseda të vazhdueshme me të akuzuarit V.I., B.I., L.V. dhe F.G., përmes internetit dhe ka qenë në dijeni për ekzistimin e grupit terrorist, e cila ka qenë në përbërje të akuzuarve V.I., L.V. dhe F.G., ndërsa te të akuzuarit L.M., të cilin janë gjetur janë gjetur tre fishek gjuetie me kal.12mm, një jelek taktik i ushtrisë, 20 fishek të kal.7.62mm, 30 fishek të kal.7.62mm dhe karikator, ndërsa te i akuzuari B.P., në shtëpinë e tij është gjetur në pushkë gjysmë automatike me 80 copë fishek të kal.7.62mm, një çantë e pushkës dhe 6 kërre për fishek dhe nga kjo del se gjykata drejt ka aplikuar ligjin penal nga neni 385 par.1 të KPP.

Gjykata e Apelit, veprën penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 179 nën par.1.9 lidhur me nenin 31 të KPRK, e më afër të përshkruar si në dispozitivin II të aktgjykimit, e cilësoi në veprën penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK, kjo për arsye se nga përshkrimi faktik i dispozitivit të aktgjykimit dhe nga shkresat e lëndës vepra penale ka mbetur në përgatitje dhe nuk kemi privim të personit zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrë zyrtare, e nga kjo rezulton se nuk kemi fare pasoja të privimit nga jeta të ndonjë personi zyrtar dhe për këtë arsye gjykata e ri cilësoi veprën penale, e me këtë evitoi edhe shkeljen e ligjit penal.

Ankesa e PRSK-së është e pabazuar lidhur me të akuzuarin B.I., i cili ka qenë i akuzuar për veprën penale kryerja e veprës terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, ndërsa gjykata e ka shpallur fajtor për veprën penale mos lajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste nga neni 142 par.2 lidhur me nenin 385 par.2 nën par.2.4 të KPRK, dhe nga shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari B.I., nuk ka pasur dijeni se me të akuzuarit V.I., L.V. dhe F.G., kanë pasur për qëllim kryerjen e veprës terroriste dhe për këtë ka kuptuar në kufi, në kohën kur i akuzuari V.I., ka kaluar kufirin në këmbë dhe aty ka kuptuar nga i akuzuari Visar se ka mundësi për të bërë ndonjë sulm terrorist ndaj izraelitëve dhe gjykata drejt ka vepruar dhe ka dhënë argumente të qarta lidhur me ri cilësimin e veprës penale që të akuzuarin B.I., ta shpallë fajtor për veprën penale fshehja mos lajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste nga neni 142 par.2 lidhur me nenin 385 par.2 nën par.2.4 të KPRK, e kjo për faktin se i akuzuari B.I., as që ka pasur qëllim dhe dashje për kryerjen e veprave terroriste të cilat kanë qenë të planifikuara nga të akuzuarit V.I., L.V., F.G., A.A. dhe L.G..

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në ankesën e PRSK dhe në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit K.P. nuk është paraqitur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese për ashpërsimin e

dënimeve ndaj të akuzuarve V.I., B.I., L.V., F.G., K.P. A.A., L.G. L.M. dhe B.P., dhe në ankesën e PRSK vetëm cekën elementet e veprave penale që kanë të bëjnë me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, radikalizmi dhe ideologjia militante e të akuzuarve, e të cilat në përgjegjësi paraqesin elementet e veprave penale për të cilët të akuzuarit janë shpallur fajtor dhe ankesa nuk cek asnjë element specifik rëndues që kishte me ndikuar në ashpërsimin e dënimit, edhe në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit K.P. nuk është paraqitur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese që kishte me ndikuar në zbutjen e dënimit dhe të gjitha rrethanat gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin, për et akuzuarin K.P. e të cilat janë cekur në ankesë janë marrë për bazë nga gjykata dhe për këtë arsye dënimi i shqiptuar është në proporcion me veprën penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit K..

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të ankesave të mbrojtësve të akuzuarve V.I., B.I., L.V., F.G., A.A., L.G. L.M. dhe B.P., ka gjetur se gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të duhur të gjitha rrethanat lehtësuese e të cilat shkojnë në dobi të akuzuarve duke marrë parasysh se të akuzuarit gjerë më tani nuk kanë qenë të dënuar, e kjo tregon se sjelljet e tyre të mëparshme kanë qenë në harmoni me normat pozitivitet të shoqërisë, se të akuzuarit V.I., B.I., F.G., K.P. A.A., L.M. dhe B.P., janë të pa punë, se i akuzuari B.I., L.M. dhe B.P., janë familjar, se të akuzuarit janë të gjendjes së varfër ekonomike, të akuzuarit A.A., K.P. dhe B.P., kanë pranuar fajësinë, gjë që nën kupton pendimin e thellë të tyre dhe me mos besimin e tyre të këtyre rrethanave personale të akuzuarve dhe gjendjen e tyre ekonomike gjykata e ndryshoi aktgjykimin lidhur me vendimin mbi dënimin dhe të akuzuarit V.I., ia shqiptoi dënimin unik në kohëzgjatje prej 8(tetë)viteve në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.04.11.2016 e tutje, si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 1800Euro, të akuzuarit B.I., ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)vite e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.04.11.2016 deri me dt.16.12.2016, të akuzuarit L.V., ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër)viteve, e në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.04.11.2016, e tutje, të akuzuarit F.G., ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër)viteve, e në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.09.11.2016, e tutje, të akuzuarit L.G. ia shqipton dënimin unik në kohëzgjatje prej 5(pesë)vite e 3(tre)muaj, e në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.06.11.2016 e tutje, të akuzuarit L.M., ia shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)vite, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.04.11.2016, deri me dt.13.04.2017, e duke marrë parasysh se nuk janë paraqitur pasoja të dëmshme, dhe janë ndërmarr vetëm veprime përgatitore nga ana e të akuzuarve edhe përkundër asaj që vepra penale konsiderohet si e përfunduar dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dënimet e shqiptuara të cekura më lartë janë në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe dënimet e këtilla do të shërbejnë preventives individuale që të akuzuarit në të ardhmen mos kryejnë vepra penale të këtilla apo tjera, si dhe preventivës së përgjithshme që dënimet e këtilla të shqiptuara të akuzuarve të ndikojnë edhe te të tjerët në parandalimin e kryerjes së këtyre veprave penale, dhe pritet në tersi të arrihet edhe qëllimi i dënimit të paraparë si në nenin 41 të KPRK.

Si u cek edhe më lartë, u deshtë të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e në bazë të nenit 403 par.1 dhe 401 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.365/2018, me dt.17.09.2018

Procesmbajtës,

Anëtarët e Kolegjit,

Kryetare e Kolegjit,

Përparim Zeka

Fillim Skoro

Have Haliti

Abdullah Ahmeti